

BEGZAT BRAHMANI

**MREKULLITË
E
KUR'ANIT**



BEGZAT RRAHMANI

MREKULLITË E KUR'ANIT
POEZI FETARE

FENIKS-KËRÇOVË, 2003

Redaktor: Safet Q. Purellku

Recensentë: Shaban Aziri
Abdurrahman Asllani

Lektore: Gëzime Baftiri

Radhitja kompjuterike: Feniks-Kërçovë

Ballina: Rijad Bajrami

Boton shtyp: Feniks-Kërçovë

**Botimin e financoi BASHKËSIA ISLAME-REGENSDORF
ALTHARDSTRASSE-10 8105 ZURICH-ZVICËR**

PRINDËRVE TË MI:

NËNË-TAMANES DHE BABË-RASIMIT ME PËRKUSHTIM

Fjala e recensentit:

Autori Begzat Rrahmani prezantohet para lexuesit shqiptar me një punim të rëndësishëm të veçantë dhe të një niveli të lartë të artit poetik. Autori duhej përgëzuar për kurajën në ndërmarrjen dhe guximin që mëton të thyej tabunë e krijuar gjatë sundimit monist i cili gati që ia arriti ta shabllonizojë gjuhën e shpirtit. Pra Begzat Rrahmani në këtë libër ofron një krijimtari të re shpirti, me frymë fetare **ISLAME**, ku haset stili bashkëkohor i të shprehurit të ndjenjave të cilat i ndien autori në tërësinë e tij shpirtërore.

Libri do të përmbush një nevojë të ndjeshme të lexuesve dhe një zbrazëti në bibliotekën tonë të deritanishme për publikun e gjerë.

Punimi dinjitoz e kurajoz mjaftë i rrallë, është fryt i një pune pasionante disa vjeçare shkruan me kompetencë profesionale, autori përmes poezisë rrahë me realizëm e objektivitet probleme tepër të gjera dhe të shumë anshme. Motivi Islam është bazament mbi të cilën është shkruar ky libër, gjë që krijohet një zhanër i ri në krijimtarinë shqipe.

Shaban AZIRI

ZOTI

Ndër emrat-
Më të bukur në botë
Është i PLOTFUQISHMI
Ne me kënaqësi i themi **ZOT**.

Është i vetmi-
Që zotëron gjithësinë
Për të mbijetuar
Autorizoi NJERËZINË.

Mundohej djalli i mallkuar
Të bëhej zot mbi ZOT
Por kurrë s' ka mundur
E s' do të mundet as sot.

ZOTI na dhuroi
KUR' ANIN plot mençuri
Udhërrëfyes të jetës
Për njerëzimin SHPËTIM.

KRIJESAT

Bota është ndërtuar
Bukur deri sot
Veç Zoti e din
Sa kanë kaluar mot.

Engjëjt ishin
KRIJESA TË BUKURISË
HAVA DHE ADEMI
Krijesa të NJERËZISË.

Ngelën në tokë
Të shijojnë bukuritë
Me urdhër të Zotit
Të rrisin fëmijët.

Njëzetepesë njihen
-PROFETË BURRA-
Prej atyre të tërëve
AI I KUR' ANIT është GURRA.

LIBRAT E SHENJTË

Librat e shenjtë
Zbritën prej qiellit
Të na ndriçojnë rrugën
Si rrezet e diellit.

Ata janë shumë
Por më i miri-Kur' ani
Dhuratë që s' ka çmim
E çdo myslimani.

ME AJETET KURA' NORE
Dita e mbarë fillon
Po ashtu me Ajete
Në dhomën e gjumit mbaron.

AJETI I PARË

Fortë u gëzua XHIBRILI
Për rrugën në SHPELLËN HIRA
Pasi aty do të fillohej vepra
Në këtë botë më e mira.

U trondit në zemër ai NJERI
HIRA u bë rrugë pa fund
Kur drita shkëlqeu mbi Mekë
Dhe errësira mori fund.

NË TRURIN E PASTËR NJERËZOR
U MBOLLË AJETI I PARË
XHIBRILI U KTHYE SHPEJT TE ZOTI
Sihariqin për të marrë.

Lëvdatat s' patën fund
XHIBRILI priti tjetër udhëzim
Pasi e kuptoi mirë misionin
Për njerëzimin-KUR' ANI SHPËTIM.

VEPRA E VEPRAVE
-MUHAMEDIT A . S-

Njeriu lëvdohet
Për vepra të mira
Siç u vulos në Kur' an
Në shpellën HIRA.

Prej lartë vërente
Vendlindjen si diell
E zhdukte errësirën
Si hëna prej në qiell.

ZOTI fjalën ISLAM
Ia futi thellë në zemër
-VEPRA E VEPRAVE-
Në botë i dhe emër.

KUR' ANI ËSHTË SHKENCË
Por edhe arsye
Njeriut ia mundëson
Të zgjidhi çdo nyje.

SHPIRTIN KUSH TA KA DHËNË

Na përcolli ZOTI
Me gëzim në këtë jetë
Për sprovimin e shpirtit
A do të jetë i vërtetë?!

Fjala e dytë
Që mësova ishte nënë
Por përherë më thotë truri:
-SHPIRTIN KUSH TA KA DHËNË-?!

Largohu nga mëkatet
KUR' ANI siç na mëson
Duke venduar kokën në sexhde
Edhe sevapet i fiton.

Shpirti kthehet në vend
Donë apo s' donë ti-
Bindu në Zot e Kur,an
-ATA JANË VETËM NJI-.

TRURI I SHËNDOSHË

Trurin i shëndoshë
Se kënaq pasuria
Prandaj atë kurrë
Se kalb as vobekësia.

Zbaton urdhrat
E Krijuesit të tij
Pa asnjë pengesë
Qëllimet ti arrijë.

Gjatë jetës së shkurtër
Ai s' është lakmues
Prandaj te Krijuesi
Përherë del fitues.

Padrejtësitë e ferri
Ai asnjëherë si dëshiron
-LEXIMI I KUR' ANIT-
Rrugën ia trason.

DIJENIA

Armikut i falet jeta
Nëse të jep dijeni
Si robërve të luftës
Që ua falën lirinë.

Lufta me armë
Derdh vetëm gjak
Kurse lufta e dijenisë
Mirë duhej mat.

Njeriu i pajisur
Me plot dijeni
Kurrë se lodh trurin
Ai për pasuri.

Prandaj armikut
Ia falën lirinë
Pasi prej tij
Armatosën rininë.

Kjo mirë thuhet
Te i madhi KUR' AN
Obligim për dijeni
Myslimanët kanë.

KRIJESA E MENÇUR

Atëherë kur lindi
Pata plot gëzim
-KRIJESA E MENÇUR-
Në truallin tim.

Aty ku shkelnin
Ndieja gjallëri
E aq më tepër
Kur pritej fëmijë.

Me krijesën e mençur
Tash s' di ç' ndodh
Çdo gjallëri te unë
Trurin të lodh.

Harron Kura' anin
Dhe të ZOTIT POROSI
Mendon se vdekja
Kurrë s' do ti vijë!

BESIMTARI

Djalli thirri besimtarin
Ku kishte haje e pije freskuese
Ta bindi në rrugën e tij
Pasi ajo është e drejtë dhe shëruese.

Aroma e mishit të pjekur
Mbushte krejt hapësirën
Djalli bisedonte duke përtypur
E thoshte: merr unë ta dua të mirën.

Besimtari përgjigjej duke qeshur
Ti je i “vërtetë” tregohesh me vepër
Por këtë haje e pije me aromë
E lëmë për një kohë tjetër.

Djallit i pëlçiste zemra
Pse i shkonte huq harxhimi
Besimtari prapë duke qeshur tha:
-HAJA E PIJA PËR MUA ËSHTË AGJËRIMI-.

Këtë e kam mësuar
Nga KUR’ ANI FAMËLARTË
Ehe pse ti djall
Për keqësim qenke i zjarrtë.

MREKULLITË E KUR' ANIT

Mrekullitë e ditës
Janë kënaqësi shpirtërore
Por ato të KUR' ANIT
Për jetën janë prore.

Sa pasuri ka toka
Aq Mrekulli ka në KUR' AN
Devotshmëria ndaj ZOTIT
Dashuri për V A T A N.

Me dijeni të thellë
Mrekullitë i kuptoni
Siç e dini se një ditë
Edhe ju do të shkoni.

Mrekullitë e jetës
Do ti keni në amshim
Por nëse me Kur' an
Keni qenë në kalim.

EZANI

Në minare thuhen
Fjalët më të bukura
Ai që i dëgjon me zemër
Lehtësohet si flutura.

Drejtë SHTËPISË SË ZOTIT
Rruga i del përpara
Djalli shqetësohet
Orët si ka të mbara.

Për jetën e amshuar
Punohet në këtë botë
Lexoni dhe veproni
KUR' ANI Ç' THOTË.

XHAMIA

Sa e bukur kjo shtëpi
Në tërë gjuhët i thonë Xhami
E kjo pjesë që lartëson
Me EZANIN krejt gjallëron.

Mbushet plot
Pesë herë në ditë
Falim dy festa
Për çdo vit.

Njëra e Agjërimit
Tjetra e flijimit
Dashuri ndaj Zotit
E tërë njerëzimit.

E ka caktuar Zoti
Për lexim të KUR' ANIT
Ku vendohen themelet e Fesë
Por edhe ato të VATANIT.

DREJTËSIA DHE OBLIGIMET

Për çdo falje NAMAZ
Përherë merr ABDES
Pastro trup e shpirt
Pasi s' dinë kur vdes.

Çelësat e Parajsës janë
-DREJTËSIA DHE OBLIGIMET-
Për epshet e shfrenuar
Vinë edhe dënimet.

Ato që e duan ryshfetin
I bëjnë dëm njerëzisë
Harrojnë Drejtësinë e obligimet
Dhe dënimet e PERËNDISË.

DITËN E GJYKIMIT
I shoqëron djalli e mëkatet
Engjëjt do të dëshmojnë
Çdo vepër në peshore matet.

Prandaj lexoni KUR' ANIN
Zbatoni rregullat e Drejtësinë
Të jeni të devotshëm
Të besoni PERËNDINË.

NAMAZI

Lutjet të pranohen
Kur i bënë me kënaqësi
I frenon tërë epshet
S' mendon për prapësi.

Me ABDESIN e mëngjesit
Dita të shkon mbarë
-NË LIBRIN E ZI-
Kurrë nuk hedhë farë.

Djalli s' të afrohet
Të përqesh prej karshi
Duke të treguar ata
Me të cilët ka shoqëri.

Ti vazhdon rrugën
Të trasuar me KUR' AN
Pa mos dëgjuar fjalët
Djalli e shokët ç' thanë.

DO TË ZGJOJ PËR SYFYR

Unë ndihem MUSLIMAN
Prandaj dua të AGJËROJ
Babi pak u hidhërua
Por ashpër s' reagoj.

Dikur mami tha: do të bëjë
Ushqim të pastër e të mirë
E unë do të zgjoj tha babi
Tërë AGJËRIMIN për syfyr.

Ta jap edhe fjalën bijë
Kurrë më s' do të pijë raki
-DREKËN E BAJRAMIT-
Do ta hamë në shtëpi.

Do ti kërktoj ca libra
Një shoku MUSLIMAN
-babi unë kam lexuar KUR' ANIN
Por edhe libra të tjerë kam.

I lumtur është ai fëmijë
Që në mitër fillon si MUSLIMAN
Rritet me dashuri ndaj ZOTIT
Si rrugë ka të SHENJTIN KUR 'AN.

LUTJET

Prej lutjeve të ditës
Shpirti pastrohet
Si në ditët e AGJËRIMIT
Kur trupi shkarkohet.

Përjetohen dhimbjet
E trupit njerëzor
Atyre që u mungon
Ushqimi ditor.

Kujtojmë obligimet
Si krijesë me vetëdije
Kthehemi nga e mbara
-POROSI PERËNDIE-.

KUR' ANI FAMËLARTË
Na mëson të jemi tok
Me ndihmën e ZOTIT
Bima rritet në BOKË.

NATA E MADHE

Në këtë NATË të MADHE
Ne të gjithë festojmë
Duke iu lutur ZOTIT
Dhe e falënderojmë.

Që na bëri njerëz
Na solli në jetë
Të përgatitur të shkojmë
Ne në AHIRET.

Në këtë botë
Askush s' ka mbet
Mirësitë hapin derën
Për në XHEHENET.

Me lexim të KUR' ANIT
Dimë për dje dhe sot
Prej mrekullive në te
Derdhim edhe lot.

ZEQATI

Çdo pasuri tepricë
Dëmton shpirtin njerëzor
Kthen atë në egoizëm
E bënë tiran dhe mizor.

Për tepricë pasurie
Me KUR' AN jepet ZEQATË
Hiqen epshet egoiste
E keqja pritët me shpatë.

Mbyllet dera e ferrit
KUR' ANIN KEMI NË ZEMËR
Djalli pëlçet nga inati
Mirësitë na japin emër.

FESTA E MADHE

Në uri kemi lehtësim
Me Ajetet e KUR' ANIT
Obligimet ndaj ZOTIT
Dobitë e Ramazanit.

Lehtësim ka trupi
E shpirti pastrim
Në SHTËPINË E ZOTIT
Pjesëmarrja obligim.

Të shtrihet dora
Të zhduken hidhërimi
Për FESTË E MADHE
NGA ZEMRA URIMI.

Siç rrjedhe dijenia
Prej AJETEVE KUR' ANORE
Devotshmëria Islame
Duhej të jetë prore.

AGJËRIMI

Agjërimi është
-FESTA MË E GJATË-
Si për burrat
Ashtu dhe gratë.

Fëmijët bëjnë gara
Në lexim të KUR' ANIT
Të tërë kokën lart
Që i përkasin Islamit.

Krejt pas dreka
Është obligim
Për IFTARIN
Përgatitet ushqim.

Aroma e këndshme
Forcon vullnetin
Prej ZOTIT E KUR' ANIT
Dhuratë XHENNETIN.

BASHKIM ZEMRASH

Kur bashkoni zemrat
Me ato pa fuqi
Ju vërtetoni fjalën
Te ZOTI SI NJERI.

Kur buzëqesh fytyra
Në rrugë namaz shoqëri
Ua lehtësoni pak dhimbjet
Atyre pa shëndet e mundësi.

Ushqimi rëndon trupin
Sa mëkatet me qëllim
-MUAJI AGJËRIMIT-
Sjell shëndet e pastrim.

Këtë e gjejmë
Në AJETET KUR' ANORE
Prandaj ju o njerëz
Punoni e lexoni prore.

DITA E BEKUAR

Me sofrën e mbushur
Gëzohet fëmija
E mua më dhemb zemra
Në botë mbretëron varfëria.

Dora jonë e gjatë
Zbut dhembjet në botë
-DITËN E BEKUAR-
Të mos derdhen lot.

Për këtë na obligon
-I MADHI ZOT-
Obligimet kush si kryen
Pasurinë e ka kot.

LEXONI KUR' ANIN
Ç' thotë për pasurinë
Hisja e tepruar
Shpëtim për varfërinë.

PAS BUKE

Të falënderohemi
TY O ZOT-
Që na mundësove
Të ulemi në sofër sot.

Të hamë e të pimë
Tri herë në ditë
Të kënaqemi me fëmijët
Ne duke i rrit.

Lutjet i bëjmë për Ty
Lëvdatat për të dërguarit Tuaj
Mundin për të vobektit
Që askush të mos vuaj.

TË REPEKTOJMË O ZOT
Dhe kërkojmë shpëtim
TE KUR' ANI FAMËLARTË
Që e kemi RRUGËTIM.

VEPRAT E MIRA

Besimi në ZOT
Është devotshmëri
Jeta e amshuar
Plot lumturi.

LEXIMI KUR' ANIT
Na kthjellon trurin
Hapin shtigje
Shkatërrojmë murin.

Mbajtja e pastërtisë
Na fal shëndetin
-VEPRAT E MIRA-
Na falin XHENNETIN.

Pastrojmë trupin
Me AGJËRIMIN
Madhërojmë KUR' ANIN
Dëshmojmë njerëzimin.

POROSIA

Duhej të shkoj nënë
Kam takim me një shoqëri
Mirë bir, urdhëro teshat
Pastrohu, vishu e bëhu zotëri.

Siç je i pastër me tesha
Të jesh edhe me fjalë
Të thonë të pranishmit
Lum nëna për këtë djalë.

Të faleminderit nënë
Për kujdesin dhe porosinë
Më lehtësove shpirtin
Më zbukurove rininë.

Të dhëntë ZOTI jetë nënë
Të arrish thellë pleqërinë
Edhe unë të kujdesem për TY
Hallall të ma bësh fëmijërinë.

Nëna bëri porosinë
Siç bëhet me KUR' AN
Të gjithë MUSLIMANËT
Këtë amanet e kanë.

KURBANI

Është kënaqësi
Të flijosh për njerëzinë
Për-FESTËN E MADHE-
Të gëzosh shtëpinë.

Sofra e mbushur
Për- DREKËN E BAJRAMIT-
Dashuri ndaj ZOTIT
Dëshmi të ISLAMIT.

Të nderosh të vobektit
Është vepër madhështore
Prej tyre dhe ZOTIT
Merr urata prore.

Është obligim
Që shkruhet në KUR' AN
Në emër të ZOTIT
Edhe dhembje s' kanë.

ANALIZONI VETITË

Mendimet apo tezat
Të gjitha janë kot
Pasi i vërtetë është
-VETËM NJË ZOT-.

Është atje tej ju
Por është edhe tek unë
Menjëherë ZOTI
Kurrë s' përdor dhunë.

DITËN E GJYKIMIT
Do të bindeni vetë
Herët ose vonë
Askush këtu s' mbet.

T'i kthehemi të vërtetës
T'i lejmë prapësitë
Pasi kemi tru e shpirt
T'i analizojmë vetitë.

Këtë e vërteton
I SHENJTI KUR' AN
Nëpër shumë SURE
AJETET e thonë.

SHËRIM I DHEMBJEVE

Kur i shikonte idhujt
Punët si shkonin mbarë
Prandaj i urrente-
Ai burrë MENDAR.

Dhembjet si fëmijë
Ia shëronte fjala ZOT
Punët, mendimet e lutjet
Kurrë si shkonin kot.

Ikte larg në mal
Prej urrejtjes e padijenisë
I lutej e falej ZOTIT
Për shpëtim të njerëzisë.

Me KUR' ANIN I BINDI
Të besonin në NJË ZOT
-VEPRA MË E MADHE-
Që njihet gjer sot.

MREKULLITË

Në jetë përgatitemi
Ne për dy jetra
Duam apo s' duam
Pas kësaj vjen tjetra.

Ti lejmë prapësitë
Të kapim dijeninë në botë
Sepse hidhërohet ZOTI
Pse jeta harxhohet kot.

Mrekullitë i shohim
Dhe ndjemë kënaqësi
Me AJETET e shpallur
Pajisemi me dijeni.

Me zemër e shpirt
Si trembemi amshimit
Nëse lexojmë KUR' ANIN
Dhe shkojmë drejtë trasimit.

GJUHA

Çdo gjuhë e cicërimë
Janë të ëmbla - sheqer
Prandaj njëra për tjetrën
S' duhej të vjellin vrer.

Krijesave shpirtin
ZOTI ua jep
Prandaj të privilegjuar
S' duhej të ketë.

ZOTI pranon faljen
Dhe fjalët e mira
Prandaj hiqni nga truri
Prapësitë, veset e smira.

Çdo gjuhë e cicërimë
ZOTI mirë e kupton
Por atë të KUR' ANIT
Më shumë e lëvdon.

LEXIMI THYEN VETMINË

Veprat shtojnë jetën
Leximi thyen vetminë
Butësohet edhe shpirti
Mendon për njerëzinë.

Largohet frika e vdekjes
Pasi në zemër s' ka vend
Prapësia kthehet në mirësi
Je kthjelluar në mend.

Jeta bëhet e lumtur
Si lulet me vesë
Shpërndahet aroma
Si rrezet në mëngjes.

Zmadhohet njerëzimi
S' ka keqësim në letër
Ashtu pëlçet djalli
Para ZOTIT s' ka vepër.

I dalim ZOT KUR' ANIT
-VEPËR MË MADHËSHTORE-
Që në zemrat e besimtarëve
Do të ndodhet prore.

FUQIA E ZOTIT

Për zemërbardhësi
Beronja bëhet nënë
Nëse nuk besoni-lexoni
Në KUR' AN ç' Është thënë.

S' besonte as vetë
Pasi ishte në moshë
Por BERONJA lindi fëmijë
Të pashëm e të shëndoshë.

Pati shumë mendime
Etiketimet ishin kot
Pasi e vërteta është
-FUQI KA VETËM NJË ZOT-.

Të pa mundurën
E bënë vetëm ZOTI
Besoni KUR' ANIN, o njerëz
Do të teret edhe loti.

NJË POROSI

Jeta është për ty
Por vdes pa dëshirë
-PARAJSA FITOHET-
Me vepër të mirë.

Pyetje ka shumë
Në jetë e amshim
Këtu të mbron gjyqi
Por atje s' ka lëshim.

Në këtë botë vjen
-ME NJË POROSI-
Për vepra të mira
Dhe njerëzimit liri.

Çdo vepër regjistron
Një ENGJËLL për ne
Që e mbajmë tërë jetën
Por kurrë s' futet në dhe.

Nëse lexoni KUR' ANIN
Do të bindeni vetë
Çdo e thënë e ZOTIT
Është e vërtetë.

ADHURIMI

Nëse adhuron ZOTIN
Prej frikës apo autoritetit
Lutjet e faljet që bëni
Avullohen e gjë s' mbeti.

ZOTI adhurohet
Me plot devotshmëri
Pa shikuar anësh
Shpirt pastër, pa dredhi.

Nga thellësia e zemrës
KUR' ANI I PASTËR LOT
Ku përmendet ZOTI
Lutjet kurrë s' janë kot.

Dini shkrim lexim
Ju që i thoni vetes njeri
ZOTIN E KUR' ANIN
Përherë mbani në gji.

DERA E GJYKIMIT

Pastro shpirtin
E kthjello trurin
Prapësitë shkatërrojnë
Drurin por edhe gurin.

S' je i përjetshëm
Këtu në tokë
Ndero familjen
Miq të dhe shokë.

Nëpër derën e Gjykimit
Do të kalosh pa tjetër
Vepra e bërë-
Kurrë s' bëhet e vjetër.

Prapësitë t'i frenon KUR' ANI
Të vendon rregulla në jetë
Lexo me vëmendje
Dhe bindu ti vetë.

KRIJUESI I BOTËS

Pas lindjes
Vazhdoni mësimin
T'u pastrohet truri
Dhe forconi besimin.

Largoni POLITEIZMIN
Për ZOTIN E VËRTETË
-KRIJUESIN E BOTËS-
Por edhe KIJAMET.

Me vepra të mira
Nderoheni në jetë
Dhe hapni rrugën
Për në XHENNET.

Jeta është e shkurtët
Sa frutat në pemë
ME AJETET KUR' ANORE
Forcojmë e shijojmë FENË.

MËKATI I KABILIT

Jetën njeriut
Ia falë PERENDIA
Prandaj bëni të mira
E kurrë të këqija.

Zhdukni egoizmin
Mos i lakmoni vetmisë
Rruga e drejtë-
Është ajo e PERENDISË.

Mëkati i Kabilit
S' duhej bërë kurrë
Prandaj o vëllezër
Vendoni sinor-mur.

KUR' ANI na mëson
Jetën e fall ZOTI
Atëherë O NJERËZ
Pse të derdhet loti?!

FJALËT: ZOT-NJERI

Te GURI I SHQIPONJËS

Qëndron repetitori

Fotografi të patër

Të ketë televizori.

Dritare e shtëpisë

Për të parë në botë

Çka ndodhur dje

E çka ndodhur sot.

Truri i mësuar

Në botë bënë çudira

-SI NJERIU I MIRË

TE SHPELLA HIRA.

Fjalët :ZOT- NJERI

Që erdhën në atë SHPELLË

KUR' ANI I MADHËRUAR

Ti ngulit në zemër thellë.

KËNGË VAJI

Shkruaj këngë vaji
Për bilbilat këngëtar
Ta këndojnë në Kosovë
Për vëllezërit kosovarë.

Heronjve të Drenicës
Shpirtrave mbi varr
-NËNËS KOSOVË-
-FLAMURIT KOMBËTAR-.

Përherë kuçedrës
I kanë thyer dhëmbë
Se janë të fortë
Përherë si shkëmb.

Prej shtatë kokësh
I kanë ngelur edhe tri
Për Ju vjen pranvera
Ajo prapa gjyqit rri.

E ka dënim nga ZOTI
Ato s' besojnë KUR' ANIN
Për egoizëm të vet
Donin çdo burim të thanin.

PËRBINDËSHI

Të futet me sinor
Dhe të bëhet hisedar
S' ka fije turpi
Para ZOTIT mëkatar.

Shkul fëmijën nga barku
Të porsa formuar në mitër
Kënaqet me vdekjen e nënës
Që gjatë kohë e ka pritur.

Me dhëmbët katarosh
Përtyp krijesën e njomë
E mallkojnë nënat këtë
Që PËRBINDËSH i thonë.

KUR' ANIN ndalon
Marrjen e jetës
Pasi vetëm ZOTI
Është falës i krijesës.

HAKMARRJA

Hakmarrja të shëmton
Ty o njeri-
Djali të trason rrugën
Për krime e ç' njerëzi.

Jetën na fal ZOTI
Prandaj duhej shijuar
Të falësh gjakun
Bëhesh i madhëruar.

Këtë e tha Muhamedi as.
Në malin ARRAFAT
Falja e gjakut të ungjit
Jehoi shpat më shpat.

Si KUR' ANI FAMËLARTË
Edhe MUHAMEDI as. S' pati gabim
Çdo mysliman i devotshëm
Këtë e ka rrugë rrëfim.

BUTËSI SHPIRTI

Kur të preket shpirti
Digjesh në zemër
I kthehesh ZOTIT
Dhe përfiton emër.

Ia lehtëson vuajtjet
Atij që kërkon mëshirë
Pastaj të vjen URATA
-u GËDHIFSH SHËNDOSH E MIRË-.

Ai që s' ka shpirt e zemër
Është një copë kallkani
E urren vet ZOTI
Por edhe tërë VATANI.

Duke lexuar KUR' ANIN
Ndien në zemër butësi
Përherë të thotë shpirti
Për njeriun duhej liri.

JETA ËSHTË E SHKURTËR

Dy kushte janë
Që të bëjnë njeri
Truri i shëndosh
Dhe fjala njeri.

KOMBI PËR NË JETË FEJA PËR NË AHIRET

Jeta është e shkurtër
Nëse s' je në terr
Ke hedhur lakminë
Të huaj kurrë s' merr.

Në Parajsë shkohet
Me vepra të mira
Rikujtohu ç' ndodhi
Në SHPELLËN HIRA.

I dashuri i ynë
I radhiti në KUR' AN
ENGJUJT E ZOTIT
Fjalët që thanë.

VARRI

Emri dhe mbiemri
E ruajnë varrin
Veprat e shkruara
Madhërojnë dijetarin.

Rreth e përqark
Kundërmon aromë
Pasi fjalë të mira
Vizitorët thonë.

Ai pushon qetë
PARAJSEN e ka shpërblim
Rruga e drejtë
Për njeriun shpëtim.

Rrugën e ka gjetur
Duke lexuar KUR' ANIN
Që rrënjët e prapësive
Fjalët e bukura i thanin.

DITA E KIJAMETIT

Fytyrën ta zbardh
Sjellja dhe vepra e mirë
Kurse ajo e shëmtuara
Përherë ta nxirë.

Ai që bënë keq
Përjeton kënaqësi
Edhe pse të dëmtuarit
E shikojnë me sy.

DITËN E KIJAMETIT
Vetveten do ta kemi në pasqyrë
Disa do të krenohen
Të tjerët do të kenë mynxyrë.

Kur veprat do të prezantohen
Atëherë s' ka pendim
Gëzim për besimtarët
E për gabimtarët dënim.

Mbi shpinë do të kenë barrë
Të dëmtuarit do të marrin pasurinë
Mëkatet do të kënaqen
Duke i rënduar mbi shpinë.

Do të pendohen që s' punonin
Me rregullat e KUR' ANIT
Por bënë gabime
Që i ndalohen ISLAMIT.

RINGJALLJA

Trupat do të ringjallen
Si lulet në pranverë
Disa me aromë të bukur
Të tjerët me bërllok e plerë.

Pas gjumit të përjetësisë
Do zgjoheni të freskët, shëndoshë
Kurse ato mëkatarët
Të rraskapitur e karkë bosh.

Ditën e ringjalljes
E presin të tubuar me kënaqësi
Kurse ato mëkatarët
Kokë ulur dhe në vetmi.

Ata ishin në mashtrim
Kurrë s' lexonin KUR' ANIN
DJALLIN E PRAPTIT
Përherë në zemër i mbanin.

SHPIRTI JETON

Ai që lindi dje
Vdes sot
Por vetëm trupi
Shkon kot.

Shpirti jeton
Në PARAJSË-FERR
Prej kësaj bote
Veprat i merr.

Pendohet rëndë
Por krimet s' falen
Dy dritat e amshimit
Vetëm njëherë kallen.

Ç' rrugë do të marrësh
Zgjidhe me KUR' AN
Si për amshim
Ashtu dhe VATAN.

DITA E GJYKIMIT

Siç shikoni rrebeshin
Që vjel prej lartë në qiell
Ashtu do të jetë DITA E GJYKIMIT
Me bubullima,por edhe një rreze diell.

Burimi rrezeve dhe ai i shpëtimit
Janë shkruar në KUR' AN-KAPTINA
Ata me shpirt e pa mëkate
S' do të përjetojnë tmerr e bubullima.

Frikoheni për vepra të shëmtuara
Pasi përherë na ndjek një sy
AI DIT[ËN E GJYKIMIT, dëshmon
Edhe pse s' na pëlqen as mua e as ty.

Ecni rrugëve të ZOTIT
Që janë shënuar në KUR' AN
DITËN E GJYKIMIT të jeni të pastër
Pasi të shëmtuarën djajtë e kanë.

FRUTAT E ZKUMIT

Sa të shijshëm u vinin
Frutat e ZEKUMIT
E mohonin ZOTIN
Dhe UDHËZIMET E HARUNIT.

I përkuleshin BA' ELIT
Që i thoshin “perëndi”
Asaj statujë-akull
Vërtetë çmenduri.

Në zemër kishin djallin
Që i shtynte në mohim
Prandaj në jetën e amshuar
XHEHENEMIN e kishin dënim.

Atje i thoshin Ba'elit
Që i thoshin “perëndi”
Na hoqe nga KUR' ANI
Ti dhe djalli i zi.

1. Zekum-pemë që ndodhet në fund të XHEHENEMIT.
2. Ba'el-emër i një statue-zot.

Ai qesh e përqesh
Si armik i njerëzisë
Duke ikur nga KUR' ANI
Dhe këshillat e PERËNDISË.

Bibliografia kronologjike me përmbajtje fetare të autorit Begzat Rrahmani të botuara nëpër gazeta dhe revista të shtypit periodik.

1. Rrjedhe dijenia.....”Hëna e Re”nr. 21 Shkup, 1990 f. 2
2. Ikre..... 4 =====, 1991 f. 9
3. Ka’ beja s’ kishte dobi..... 5 =====, 1991 f. ?
4. S’ mendonte për pasuri Profeti..... 6/7 =====, 1991 f.?
5. Zoti e dinë punën e vet-gazetari..... 6/7 =====, 1991 f.?
6. Zoti është kudo..... 8 =====, 1991 f.?
7. Fuqinë ia dha Zoti..... 12 =====, 1991 f.?
8. Elegji politike..... 1 =====, 1992 f.?
9. Devotshmëria..... 2 =====, 1992 f.?
10. Është Ramazan..... 3 =====, 1992 f.?
11. O njerëz..... 4 =====, 1992f.?
12. Shejtani..... 4 =====, 1992 f.?
13. Tribuna e Arafatit..... 5 ===, 1992 f.?
14. Bajrami pa monizëm..... 5 =====, 1992 f.?
15. Ja-sini..... 6 ==, 1992 f.?
16. Mevludi..... 6 =====, 1992 f.?
17. Dua atmeje-gazetari 7/8=====, 1992 f.?
18. Shiko më larg..... 7/8=====, 1992 f.?
19. Ezani Billallit..... 7/8=====, 1992 f.?
20. Durimi..... 9=====, 1992 f.?
21. Sahat-Kulla..... 10====, 1992 f.?
22. Përkundër pengesave mësimi zhvillohet 11.==, 1992 f.?
23. Ktheheni burra..... 11====, 1992 f.?
24. Mendja e shëndosh..... 12====, 1992 f.?
25. Teqe mëhalla me xhami të re-gazetari 12====, 1992 f.?
26. Meremetohet xhamia Çuli baba-gazetari... 12====, 1992 f.?
27. U themelua “Mexhlis Ulema”..... 12====, 1992 f.?
28. Mbyllte e s’ hapte derë..... 1====, 1993 f.?
29. Fëmija..... 15.03. ==, 1993 f. ?
30. Dua hatme, në Kërçovë-gazetari 15.04 =====, 1993 f.?
31. Ithtarët e Zotit..... 15.07.=====, 1993 f.?
32. Debreshtarët me xhami të re-gazetari 01.08.=====, 1993 f.?
33. Veprat..... 01.08=====, 1993 f.?
34. Çdo gjë regjistrohet..... 01.08=====, 1993 f.?
35. Rruga e drejtë..... ” Vepra, shkurt Tetovë 1994 f. 31
36. Besimtarja....., “ Vepra” prill Tetovë 1994 f. 31
37. Pagëzimi.....”Hëna e re” 15.08. Shkup 1994 f. ?
38. Pas kiametit..... “Hëna e re” 15.04. Shkup 1994 f.?
39. Përbindëshi “ Vepra” 7/8. Tetovë 1994 f. 32
40. Edhe kështu thyhet akulli-gazetari..... “Hëna e re” 01.07. Shkup 1995 f. 5
41. Merhumët tanë-gazetari..... “ Hëna e re” 01.07. Shkup. 1995 f. 4
42. Amaneti i Homeinit..... “Nuri” 05.06. Beograd 1995 f. 80
43. Festa e madhe.....Super Argëtuesi 31.01 Tetovë 1996 f. 25

44. Shkatërrimi.....	Super Argëtuesi	13.03.	Tetovë	1996 f. 25
45. KUR' ANI.....	Super Argëtuesi	13.03	Tetovë	1996 f. 25
46. Besimi.....	"Hëna e re"	03.04.	Shkup	1996 f. ?
47. Fjalët e dërguara.....	"Dritarja"	nr. 10	Tetovë	1996 f. 7
48. KUR' ANI.....	"Dritarja"	nr. 10	Tetovë	1996 f. 14
49. Devotshmëria.....	"Dritarja"	nr. 10	Tetovë	1996 f. 14
50. Shpirti dhe vepra.....	"Super argëtuesi"	24.04	Tetovë	1996 f. 26
51. Lot gëzimi sikur shi.....	"Super argëtuesi"	01.05	Tetovë	1996 f. 26
52. Ja-sini.....	"Dritarja"	2/5	Tetovë	1996 f. 5
53. Tribuna fetare-mahi të vogla	"Dritarja"	nr. 4	Tetovë	1996 f. 20
54. Biseda mes dy shokëve-mahi të vogla	"Dritarja"	nr. 4	Tetovë	1996 f. 20
55. Profesori dhe ish studenti-mahi të vogla	"Dritarja"	n. r 4	Tetovë	1996 f. 20
56. Shpirti.....	"Dritarja"	mars	Tetovë	1997 f. 4
57. Tri mahi të vogla.....	"Dritarja"	mars	Tetovë	1997 f. 21
58. Rreze mirësia.....	"Hëna e re"	09.07.	Shkup	1997 f. ?
59. Betimi.....	"Dritarja"	shtator	Tetovë	1997 f. 14
60. Pendimi.....	"Dritarja"	shtator	Tetovë	1997 f. 14
61. Shpirti jeton.....	"Hëna e re"	01.11	Shkup	1997 f. ?
62. Një porosi.....	"Hëna e re"	25.12	Shkup	1997 f. 19
63. Agjërimi.....	"Dritarja"	dhjetor	Tetovë	1997 f. 13
64. Është Ramazan.....	"Dritarja"	dhjetor	Tetovë	1997 f. 13
65. Butësi shpirti.....	"Dritarja"	dhjetor	Tetovë	1998 f. ?
66. Toka është e ZOTIT botua te libri "Zoti është kudo"				1998
67. Rruga e drejtë				1998
68. Emërimi.....				1998
69. Obligimi.....				1998
70. Thuaje të vërtetën.....				1998
71. Haxherul Esvedu.....				1998
72. Truri i shëndosh.....				1998
73. Dera e gjykimit.....	"Dritarja"			1999 f. 15
74. Dita e bekuar.....	"Dritarja"			1999 f. 15
75. Zoti është kudo- vështrim "Flaka shkollari" 13.01				1999 f. 3
76. Dera e gjykimit.....	"Mirësia"	1/8	Tetovë	2000 f. 30
77. Drejtësia.....	"Mirësia"	nr. 8	Tetovë	2001 f. 3
78. Ezani.....	"Dritarja"	nr. 5	Tetovë	2001 f. ?
79. Librat e shenjtë.....	"Dritarja"	nr. 5	Tetovë	2001 f. ?
80. Gjuha.....	"Mirësia"	nr. 5	Tetovë	2001 f. 20
81. Agjërimi.....	"Mirësia"	nr. 5	Tetovë	2001 f. 20
82. Festa e madhe.....	"Mirësia"	nr. 5	Tetovë	2001 f. 20
83. Ezani.....	"Mirësia"	nr. 5	Tetovë	2001 f. 20
84. Xhamia.....	"Mirësia"	nr. 5	Tetovë	2001 f. 20
85. Ringjalla.....	"Mirësia"	nr. 7	Tetovë	2001 f. 3
86. Dituria.....	"Mirësia"	nr. 7	Tetovë	2001 f. 3
87. Festa e madhe.....	"Dritarja"	11/12	Tetovë	2001 f. ?
88. ZOTI.....prej kësaj faqeje e deri te 137, poezitë në vijim janë të botuara te vepra MREKULLITË KUR' AN-it.				

138. KUR' ANI.....të botuara te vepra RREZE MIRËSIE viti 2003	6
139. Përjetimet (Muhamedit a.s.).....	7
140. Profetët	8
141. Engjëjt.....	9
142. Besimtari.....	10
143. Nderimi i Zotit.....	11
144. Beso Perëndinë.....	12
145. Lot sikur shi.....	13
146. Ngadhënjimi.....	14
147. Vajin ndal fëmija.....	15
148. Truri.....	16
149. Shpirti.....	17
150. Guri i pushimit.....	18
151. Uratat.....	19
152. Dhurata e Perëndisë.....	20
153. Lapsi.....	21
154. Çlirimi nga misteri.....	22
155. Frymëzimi.....	23
156. Drita.....	24
157. Dituria.....	25
158. Mrekullia.....	26
159. Rreze mirësie.....	27
160. Koha.....	28
161. Lufta.....	29
162. Ja-sini.....	30
163. Vepra e dëshmi.....	31
164. Bindu o njeri.....	32
165. Jeta shpirtërore.....	33
166. Libri i jetës.....	34
167. Guri i zi.....	35
168. Besimi i drejtë.....	36
169. Rreshtimi.....	37
170. Shiu.....	38
171. Betimi.....	39
172. Përcaktimi.....	40
173. Orientimi.....	41
174. Agjërimi.....	42
175. Vizita.....	43
176. Vizitat e shenjta.....	44
177. Kurhani.....	45
178. Haxhi.....	46
179. Gënjeshtari.....	47
180. Ringjallja.....	48
181. Peshorja.....	49
182. Dera e Xhenetit.....	50
183. Leximi.....	51

184. Rrebeshi.....	52
185. Hipokritët.....	53
186. Djalli i mallkuar.....	54
187. Djalli.....	55
188. Bibliografia.....	56
189. Përmbajtja.....	61
190. O njerëzPoezi të botuara te vepra”PËRJETËSIA”	7
191. Fjalët Xhibrilit.....	8
192. Pena dhe dituria.....	9
193. Parajsa.....	10
194. Kur’ ani.....	11
195. Butësi shpirti.....	12
196. Nata e madhe.....	13
197. Veprat e bëra.....	14
198. Betimi.....	15
199. Shpirtligu.....	16
200. Festa e Madhe.....	17
201. Fjalët e ZOTIT.....	18
202. Lot gëzimi sikur shi.....	19
203. Devotshmëria.....	20
204. Pagëzimi.....	21
205. Pas kiametit.....	22
206. Vajin ndal fëmija.....	23
207. Nesër do të bie suri.....	24
208. Përjetësia.....	25
209. Etja e përjetshme.....	26
210. Ngadhënjimi.....	27
202. Rruga e vërtetë.....	28
203. Rruga e gëzimit.....	29
204. Veprat.....	30
205. Kthim nga e mbara.....	31
206. Peshorja.....	32
207. Mbilllej harmonia.....	33
208. Pasuria.....	34
209. Mrekullitë si hapësira.....	35
210. Engjëjt.....	36
211. Dija dhe morali.....	37
212. Të thella pa kufi.....	38
213. Krijuesi i botrave.....	39
214. Lartë mbajnë flamurin.....	40
215. Këtu i themi komë.....	41
216. Do të piqen buzët.....	42
217. Mohimi drejtësisë.....	43
218. S’ kalben veprat.....	44
219. Zjarri plot prush.....	45

220. Radhitë vepra të mira.....	46
221. Lufta e Qabesë.....	47
222. Shpesh të huton truri.....	48
223. Katilët.....	49
224. Devotshmëria.....	50
225. Besa dhe pajtimi.....	51
226. Rruga hap drejtimin.....	52
227. Bindet çdo njeri.....	53
228. Dita e gjykimit.....	54
229. Besimtari.....	55
230. Pendimi është burrëri.....	56
231. Mahi të vogla.....	57
232. Pendimi.....	58
233. Shejtani.....	59
234. Budallai.....	60
235. Profeshori dhe studenti.....	61
236. përmbajtja.....	63
237. Toka është e Zotit, poezi të botuara te vepra “ZOTI ËSHTË KUDO”... 5	5
238. Rrjedh dijenia-Muhamedit a.s.....	6
239. Ikre.....	7
240. Rruga e drejtë.....	8

S’ lejohet ribotimi dhe shpërndarja e librit pa autorizim të autorit.

-CIP-Katalogizimi në publikim
Biblioteka Kombëtare dhe universitare
“ Shën Kliment Ohridski”, Shkup

821. 18 (497.7) -1

RRAHMANI Begzat

Mrekullitë e Kur’ anit:/ Begzat Rrahmani.-Kërçovë: Feniks, 2003.-64 f.; 20 cm

Bibliografia kronologjike me përmbajtje fetare të autorit Begzat Rrahmani të botuara nëpër gazeta dhe revista të ndryshme të shtypit periodik/ për bibliografinë u kujdes dhe e mblodhi Gëzime Baftiri: f. 57-60

ISBN 9989-9669-7-4

COBISS-ID 51855370

